



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istog
Municipality of Istog

01 Nr.584/2025
25.06.2025

<https://kk.rks-gov.net/istog/>
Tel: 038 200 438 14

Thirrje për aplikim

Tregu Verë – Dimër



2025/26

“Tregu Verë - Dimër” është aktivitet i ideuar dhe organizuar nga Komuna e Istogut për të festuar së bashku me mërgimtarët dhe për nder të festave të fundvitit në hapësirë publike me muzikë, ushqim, pije dhe aktivitete argëtimi.

Ky treg për këtë vit do të organizohet për 68 ditë kalendarike, brenda periudhës 15 korrik 2025 - 20 gusht 2025, si dhe 15 dhjetor 2025 – 15 janar 2026 do të përqendrohet në hapësirën publike përgjatë Parkut të Qytetit - Istog. Tregu do të përbëhet nga 1 skenë për performancë, 8 shtëpiza të drurit dhe hapësira jashtë shtëpizave të paracaktuara në destinim dhe pozicion.

Përmes kësaj thirrje ftojmë të gjitha bizneset dhe OJQ-të e regjistruara që të aplikojnë për të ofruar shërbimet e tyre sipas kategorive të përcaktuara në vijim, brenda shtëpizave apo jashtë tyre, brenda 68 ditëve të tregut.

Kategoritë

Secili biznes/OJQ duhet të zgjedhë vetëm një (1) nga tre (3) kategoritë e mëposhtme gjatë aplikimit në formën e paracaktuar.

- (1) Kategoria A: ushqim dhe pije jo-alkoolike - për shërbim brenda shtëpizës
- (2) Kategoria B: ushqim i ftohët dhe i nxehtë (grill) , dhe pije jo-alkoolike - për shërbim jashtë shtëpizës
- (3) Kategoria C: pije alkoolike - për shërbim brenda shtëpizës

Orari i Punës

Hapja e tregut do të bëhet me datë 15 Korrik 2025 në ora 19:00 dhe do të mbyllet me datë 20 Gusht 2025 (Gjatë verës) kurse gjatë sezonës së dimrit Hapja do të bëhet me 15 dhjetor 2025 dhe do të mbyllet me datë 15 janar 2026. Gjatë këtyre ditëve bizneset dhe OJQ-të e



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istog
Municipality of Istog

përzgjedhura lejohen të punojnë çdo ditë, nga e hëna në të dielën, duke filluar prej orës 10:00 deri në orën 01:00 (pas mesnate). Përjashtim janë datat, 31 dhjetor dhe 1 janar ku mund të shërbehet deri në orën 03:00.

Kursimi i energjisë elektrike

Me qëllim të kursimit të energjisë elektrike, secili biznes/OJQ obligohet që në vend të energjisë elektrike të përdorë gazin (plin) si burim i energjisë për përgatitjen e ushqimit/pijeve.

Tarifat

Tarifat për shfrytëzimin e hapësirës publike në treg, qoftë në shtëpiza ose jashtë tyre, janë të përcaktuara sipas kategorive (A-C) varësisht nga hapësira e dhënë në shfrytëzim, energjia elektrike e parashikuar për t'u shpenzuar dhe administrimi/logjistika.

Me pagesën e tarifës me nënshkrimin e kontratës mjetet nuk kthehen.

- (1) Kategoria A: 100 euro (për 68 ditë)
- (2) Kategoria B: 125 euro (për 68 ditë)
- (3) Kategoria C: 200 euro (për 68 ditë)

Obligimet

Secili biznes/OJQ që merr lejen e ofrimit të shërbimeve/produkteve në tregun Verë-Dimër 2025/26 ka këto obligime:

- (1) Të bëjë pagesën e tarifës sipas kategorisë me nënshkrimin e kontratës;
 - (1.1) Transportimi i shtëpizës nga vendi ku mbahet nga Komuna deri tek lokacioni ku do të vendoset tregu, pagesa dhe organizimi i transportit behet nga vet bizneset apo OJQ-të.
- (2) Të respektojë orarin e përcaktuar të punës;
- (3) Të vendosë në vend të dukshëm çmimoren e shërbimeve/produkte;
- (4) Të sjell me vete mjetet e punës, përfshirë grillin dhe mbulesën për shërbim (kategoria B);
- (5) Të sigurojë hapësirën dhe mjetet e punës kundër dëmtimit/vjedhjes;
- (6) Të sigurohet që ka kontejner për mbledhjen e mbeturinave, i heqë mbeturinat dhe mban hapësirën përreth gjithmonë pastër;
- (7) Të mos shfrytëzojë hapësirën për kryerjen e veprave të jashtëligjshme;



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istog
Municipality of Istog

-
- (8) Të mos shërbejë/shes produkte jashtë kategorisë për të cilën ka marrë lejen;
 - (9) Të mos e jep në shfrytëzim hapësirën palëve të treta;
 - (10) Të kthejë shtëpizën/hapësirën në gjendjen e mëparshme me mbylljen e tregut dhe merr përgjegjësinë për demet eventuale.
 - (11) Ndalohet ndotja akustike brenda/jashtë shtëpizave.

Kriteret e aplikimit

Bizneset dhe OJQ-të që shprehin interesim për t'u bërë pjesë e tregut duhet të plotësojnë këto kriteret:

- (1) Të dëshmojnë se janë të regjistruara në ARBK ose në regjistrin e OJQ-ve, për të ofruar shërbimet/produktet me të cilat aplikojnë, me certifikatë (më shumë se 3 vite);
- (2) Të jenë të regjistruara me funksionim në Istog;
- (3) Të dëshmojnë se nuk kanë borxh në ATK me certifikatë jo më të vjetër se një (1) muaj;
- (4) Të dëshmojnë me katalog/foto se kanë ofruar shërbime/produkte të tilla më herët;
- (5) Në rast se aplikuesi është pronar i njëjtë apo bashkëpronar i dy apo më shumë Bizneseve/OJQ-ve dhe në rast se fiton më shumë se 1 shtëpizë nëpërmjet shortit, përfituesi duhet të zgjedhë vetëm një 1 shtëpizë.
- (6) Të nënshkruajnë dhe vulosin formën “Deklarata për shërbim” që garanton saktësinë e informatave të ndara dhe gatishmërinë e biznesit/OJQ-së të ofrojë shërbimin për 30 ditë pa ndërprerje gjatë së dimrit.

Procesi i aplikimit

Pjesë e kësaj thirrje janë forma e aplikimit dhe forma “Deklarata për shërbim”. Të dyja duhet të plotësohen sipas shablloneve dhe bashkë me dokumentet e kërkuara përcjellëse tek kriteret e aplikimit të dorëzohen në formë elektronike me e-mail në info.istog@rks-gov.net ose në Qendrën për shërbime me qytetarë deri më datën 10 Korrik 2025 ora 16:00.

Procesi i përzgjedhjes



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic Kosovo



Komuna e Istogut

Opština Istog

Municipality of Istog

Pas mbylljes së afatit të aplikimit bëhet vlerësimi i bizneseve dhe OJQ-ve sipas kriterëve të përcaktuara nga një komision i krijuar nga Komuna e Istogut dhe publikohet lista me të para-kualifikuar.

Bizneset dhe OJQ-të e para-kualifikuara do të përzgjidhen për hapësirë/shtëpizë dhe pozicion, jo më larg se 14 korrik ora 16:00.

Procesi i ankesës: Me shpalljen e listës së bizneseve/OJQ-ve të para-kualifikuara, aplikuesit mund të dorëzojnë ankesë për mos kualifikim me email në info.istog@rks-gov.net në afatin e përcaktuar në listën e shpallur.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istog
Municipality of Istog



APLIKACION - TREGU VERË - DIMËR 2025/26

Emri i Biznesit: _____

Emri dhe mbiemri i personit juridik: _____

Adresa e biznesit: _____

Qyteti: _____

Numri i telefonit kontaktues: _____

E-mail adresa: _____

Numri i regjistrimit të biznesit: _____

Numri fiskal i biznesit: _____

Numri i kartelës identifikuese: _____

- Aplikuesit për shtëpizat e destinuar për kartolina dhe dhurata punëdore me motive të festave të fundvitit, duhet ti dorëzojnë 2-3 mostra dhe menynë e produkteve.

Aplikacionet pa përmbajtje të këtyre mostrave nuk do të shqyrtohen;

- Aplikuesit e përzgjedhur janë të obliguar ti dekorojnë shtëpizat në bazë të dekorit të përcaktuar nga Komuna e Istogut , pasi që të gjitha shtëpizat duhet të kenë pamje të njejtë;
- Aplikuesit kanë të drejtë aplikimi vetëm një herë me kartelën identifikuese të një personi juridik;
- Aplikuesit në aplikacion duhet ti bashkëngjisin dokumentet përcjellëse: kopjet e certifikatës së regjistrimit të biznesit, certifikatës fiskale dhe kartelës identifikuese;
- Afati për aplikim 25.06.2025 deri më 10.07.2025 (15 ditë) | Komuna e Istogut – Objekti i Komunës / Sporteli: Shërbime për qytetarë dhe në email: info.istog@rks-gov.net



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istog
Municipality of Istog



DEKLARATA PËR SHËRBIM

Unë, i/e nënshkruari/a, _____,

i/e lindur më _____, në _____, përfaqësues/e ligjore
e

subjektit/organizatës _____ deklaroj dhe me
nënshkrimin e

kësaj deklarate betohem se:

- i. informatat dhe materialet e dhëna në aplikim janë të sakta;
- ii. kam përvojë të dëshmuar në ofrimin e shërbimit për të cilin kam aplikuar;
- iii. kam lexuar, kuptuar dhe do të respektoj obligimet e paracaktuara;
- iv. do të ofroj shërbimin pa ndërprerë me nënshkrimin e kontratës dhe pagesën e tarifës.

Çdo përgënjeshttrim në informatë, material – qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca – ose ndryshim nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në shkualifikimin e menjëhershëm dhe vendosjen në listën e zezë për ofrimin e shërbimeve të ngjashme në të ardhmen.

Emri, mbiemri _____

Nënshkrimi _____

Vendi: _____

Datë: ____/____/____



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istog
Municipality of Istog



APLIKACION I

Plotësoni informatat në vijim sipas shabllonit në formë digjitale apo manuale me shkronja të lexueshme. Aplikacionet e pa plotësuara në tërësi dhe të pa nënshkruara nuk do të pranohen. Aplikacionin së bashku me formën “Deklarata për shërbim” dhe dokumentet përcjellëse të kërkuarasi kritere tek thirrja luteni t'i përcjellni në formë elektronike në emailin info.istog@rks-gov.net deri **më 10 korrik 2025, ora 16:00.**

Të dhënat e biznesit/OJQ-së

Plotëso të dhënat poshtë emërtimit në secilën fushë

Lloji (Biznes/OJQ)	Emri	Numri i regjistrimit	Vendi i themelimit
Adresa	Uebfaqja (link)	Rrjeti social (link)	

Të dhënat e përfaqësuesit/es ligjor/e

Plotëso të dhënat poshtë emërtimit në secilën fushë

Emri dhe Mbiemri	Numri personal	Numri i kontaktit	Emaili
------------------	----------------	-------------------	--------

Kategoria e përzgjedhur

Shëno X në kuti për kategorinë e përzgjedhur. Ju keni të drejtë të përzgjedhni **vetëm një (1) kategori**.

Kategoria A Ushqim & pije jo-alkoolike ☐	Kategoria B Ushqim i nxehtë (grill) & pije jo-alkoolike ☐	Kategoria C Pije alkoolike ☐
--	---	--



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istog
Municipality of Istog

Produktet/Shërbimet e përzgjedhura

Shëno X në kuti për shërbimet/produktet që dëshironi të ofroni për kategorinë e përzgjedhur mësipër.

Ju keni të drejtë të përzgjedhni vetëm shërbimet brenda kategorisë (A-C_ që keni përzgjedhur në tabelënparaprake, pa limit.

Kategoria A

- | | | | | |
|---------------------------------------|----------------------------------|---------------------------------------|------------------------------------|---------------------------------|
| ☐ Ujë | ☐ Lëngje | ☐ Kafe* | ☐ Çaj | ☐ Jogurt |
| ☐ Senduic/Tost | ☐ Hot dog | ☐ Patatina | ☐ Krofne | ☐ Krepa |
| ☐ Waffles | ☐ Churros | ☐ Chimney cake | ☐ Fli | ☐ Mantia |
| ☐ Kifle | ☐ Pizza | ☐ Ėmbëlsira | ☐ Gështenja | ☐ Misër |

*Kafeja lejohet të shërbehet pa aparat profesional për shkak të ruajtjes së energjisë elektrike.

Kategoria B

- | | | | | |
|------------------------------------|-------------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|----------------------------------|
| ☐ Ujë | ☐ Lëngje | ☐ Kafe* | ☐ Çaj | ☐ Jogurt |
| ☐ Hamburger | ☐ Mish zgare | ☐ Perime zgare | ☐ Pulë me oriz | ☐ Supë |
| ☐ Pasul | ☐ Gullash | ☐ Ushqim deti | ☐ Mexican | ☐ Italian |
| ☐ Indian | ☐ Thai/Sushi | | | |

*Kafeja lejohet të shërbehet pa aparat profesional për shkak të ruajtjes së energjisë elektrike.

Kategoria C

- | | | | | |
|---------------------------------------|-------------------------------|--------------------------------|---------------------------------|--------------------------------|
| ☐ Verë e vluar | ☐ Puna | ☐ Birra | ☐ Koktej | ☐ Tjera |
|---------------------------------------|-------------------------------|--------------------------------|---------------------------------|--------------------------------|

Emri, mbiemri _____

Nënshkrimi _____

Datë: ____/____/____